



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.01.2021

MBLEDHJA Nr. 03,
datë 20.01.2021, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksonimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 20.01.2021, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 02 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 443, Seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë Shoqërisë “SANG 1” shpk, me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar, si dhe licencës nr. 447, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” shpk, me Vendimin e Bordit të ERE-s nr 106, datë 26.06.2019;
- 2- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW;
- 3- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;
- 4- Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e Shoqërisë “SEMAN SUNPOWER” sh.p.k, për transferim të asetëve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. ;
- 5- Për rinovimin e licencës së Shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k, Nr 115/309, Seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 6, datë 02.02.2011 dhe rinovuar me Vendimin Nr. 122, datë 14.10.2015;
- 6- Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k, Nr 115/310, Seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 02.02.2011, dhe rinovuar me vendimin Nr. 123, datë 14.10.2015;

- 7- Mbi disa ndryshime në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 140, datë 24.09.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “SHËNGJUN” me kapacitet të instaluar 2040 kW”;
- 8- Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021;
- 9- Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 230, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 415, Seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” shpk, me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 157, datë 09.07.2018;
- 10- Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 235, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 369, Seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë Shoqërisë “C.G.C” shpk, me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 73, datë 16.05.2017;
- 11- Mbi përfundimin e procedurës administrative të filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 225, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 202, Seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë Shoqërisë “HEC TRESKA” shpk, me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 80, datë 27.04.2013;
- 12- Mbi lënien në Fuqi të Vendimit të Bordit Nr. 122, datë 29.07.2019 “Mbi miratimin e Draft Kontratës ndërmjet KESH sh.a dhe OSSH sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019.

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI